



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 11 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 25.07.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR KLUBIN
FUTBOLLISTIK "GADIMJA"

I. I ipet pëlqimi Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00 € (pesë mijë euro) për Klubin Futbollistik "Gadimja" sipas kërkesës së tyre të datës 03.07.2024.

II. Shuma e cekur në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të mbështetjes financiare përkatësisht subvencionimit të klubit të cekur dhe njëkohësisht motivimit të lojtarëve të këtij klubi të ri të Komunës së Lipjanit, në kuadër të cilt ka edhe grupmosha të reja U11, U13 dhe U15 të cilët edhe marin pjesë në gara kampionale.

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për vitin 2024 për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport nga kodi i programit dhe fondi burimor 21/613/85003/200/00000/0820 .

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-400/01-35821

Lipjan, më 25.07.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

